

# Drita Alili, Mos Shko

Zemer mos shko  
hej engjulli im te lutem kupto  
se paku nje shikim me dhuro  
nese per fund te flas pe degjo.

Ti me zemren time mbreteron  
me at shikim shpirtin ma ledhaton  
gabimet gjithkush i permireson  
prej gabimeve njeriu meson.

Me meso,me trego se si te te dashuroj  
me afro me lejo vec pak tet perqafoj  
je shum e bukur per cdo nate te enderoj  
por ndarjen ne mes neve nuk mundem ta lejoj.

Kam bere gabime e pranoj  
por tash cdo gje do te ndryshoj  
me the ne fillim mos tet lendoj  
e tash don te shkosh nuk e kuptoj  
te dua,te dua,te dua si te tingelloj.

As un ndarjen se dua  
por e ndjej se sme don mua  
shume te kam toleruar  
e ti vec me ke lenduar.

Cdo gje me kujtohet mua  
qe nga dita e pare  
shume te kam duruar  
gjersa jemi ndare.

E tash koha shkon  
e kthim prapa nuk ka  
gabimet nuk ti fali  
se te gjitha i kam pa.

Por une shpresoj prap  
per nje dite me te mir  
edhe pse e di  
se kthimi eshte i veshtire.

Ref:  
Te lutem zemer mos shko  
mos u lut por me dashuro  
me trego shpirt a me do  
po po po po.

Nga un mos u frigo  
edhe nje rast me dhuro  
hej engjull me thuaj po  
te lutem me trego.

A te prekin kujtimet  
A te mungojn momentet  
mos i haro takimet  
mbaj ne mend ledhatimet.

Te gjitha i mbaj ne mend  
kur e verteta dhemb

dhe e kaluara tregoi  
kush kend e dashuroi.

Prandaj ti mos provo  
se une leht smashtrohem  
provoje njeher kupto  
sjam femer qe pendohem.

A te pengonte suktesi im  
isha aj me shume guxim  
nje sakrific qe ia vlen  
kur zemren dikush ta then.

Buzeqeshjen dua te ta kthej  
syve tu tu jap shkelqim  
asnjeher un me nuk genjej  
jeta pa ty nuk ka kuptim.

Ref:

Te lutem zemer mos shko  
mos u lut por me dashuro  
me trego shpirt a me do  
po po po po.

Ndryshimet nuk i dua  
kur me thua sje per mua  
nuk duroj me fjal te tilla  
per ty me mbyti deshira.

Jo askujt si imponohem  
gabimisht nuk dashurohem  
keto fjale ty te dedikohen  
prej teje sdua te largohem.

Fillimin mir e di  
ne kur kishim dashuri  
te vetmen pasuri  
qe e kishim un dhe ti.

Per nje fjale te mire  
nje qellim nje deshire  
nje kujtim ne kete jete  
tash mua sme len te qete.

Premtimet nuk mjaftuan  
ne sikur su kuptuam  
se ti kishe tjeter qellim  
un rezerv e pa kuptim.

Prandaj nuk te besoj  
por edhe nje rast te ofroj  
asnje gabim me sfal  
se nuk je i vetmi djal.

Ref:

Te lutem zemer mos shko  
mos u lut por me dashuro  
me trego shpirt a me do  
po po po po.